

Vendim nr. 239 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 21 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN DASHI**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2022-1005)20/509, datë 25.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2022-800(158), datë 28.04.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-520, datë 01.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 15.03.2017 Drejtoria e Policisë së Shtetit ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë një material kallëzues kundër shtetasit F.Ç., me detyrë “mjek”, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (KP), në lidhje me një rast të transmetuar në datën 01.03.2017 në një emision televiziv investigativ. Për trajtimin e këtij materiali kallëzues është ngarkuar prokurori N.T., i cili ka regjistruar një procedim penal dhe në përfundim të hetimeve, me vendimin e datës 13.06.2017, ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk provohet se personi nën hetim e ka kryer veprën penale. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim në gjykatë.

2. Ndërkohë, prokurori N.T. ka qenë subjekt rivlerësimi kalimtar sipas nenit 179/b të Kushtetutës. Në kuadër të këtij procesi, për sa i përket përmbushjes së kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka shqyrtuar informacionin publik mediatik, por edhe denoncimin e kërkuesit për veprimtarinë profesionale të atij prokurori në rastin e procedimit penal si më lart, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit N.T., ndonëse ka kryer disa veprime hetimore, sërish hetimi ka qenë i mangët. Nisur nga kjo, por edhe nga disa konstatime për çështje të tjera hetimore, në vendimin e saj përfundimtar, KPK-ja ka arritur në përfundimin se mangësitë profesionale të konstatuara nuk mund të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, por ato dëshmonin për një sjellje të tij në mospërmbushje të detyrës së prokurorit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Mbi këtë bazë, por edhe nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, KPK-ja ka vendosur shkarkimin nga detyra të prokurorit N.T., i cili, në vijim, ka paraqitur ankim përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA).

3. Duke marrë shkas nga konstatimet dhe vlerësimet e KPK-së, në datën 18.10.2021, kërkuesi ka depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme kallëzim penal ndaj mjekut F.Ç., për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së, si dhe ndaj prokurorit N.T., për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të KP-së. Në datën 25.10.2021, kallëzimi i kërkuesit i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), e cila, me shkresën nr. 1072/1 prot., datë 03.11.2021, ia ka dërguar atë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria e Durrësit*), e cila e ka regjistruar në datën 05.11.2021. Prokurori i ngarkuar për trajtimin e këtij materiali kallëzues, pas verifikimeve të rastit në fjalë, me vendimin e datës 20.11.2021, bazuar në nenet 290, shkronja “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (KPK), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se, referuar edhe vendimit nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese

(Gjykata), organi i akuzës nuk mund të hetonte ligjshmërinë e vendimmarrjes dhe urdhëresave të një gjykate ose të një prokurori apo të kontrollonte zbatimin prej tyre të procedurave ligjore, ligjit material e procedural, përderisa sistemi i së drejtës, kuadri normativ kushtetues e ligjor në fuqi dhe parimet e procesit të rregullt ligjor vendosnin shkallët hierarkike të gjyqësorit si mekanizma kontrolli ndaj gjykatave më të ulëta, duke parashikuar edhe instrumentet ligjore për ndreqjen eventuale të vendimeve gjyqësore. Po sipas prokurorit, shkresa përcjellëse e Prokurorisë së Posaçme nuk përmbante asnjë të dhënë ose indicie që të mbështeste pretendimet e kërkuarit për rifillimin e hetimeve për faktin penal të parashikuar nga neni 259 i KP-së.

4. Në datën 25.11.2021 kërkuar, në cilësinë e kallëzuesit, ka paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit të Prokurorisë së Durrësit për mosfillimin e procedimit penal. Për këtë ankim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2022-1005) 20/509, datë 25.02.2022, ka vendosur rrëzimin e tij, duke vlerësuar se vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është në përputhje me ligjin. Sipas gjykatës, edhe pse ka një mosrakordim ndërmjet datës së marrjes së vendimit të prokurorit dhe datës që mban shkresa e dërgimit të tij për njoftim kallëzuesit, kjo nuk çon automatikisht në shkelje në ligjit. Materiali kallëzues është regjistruar në Prokurorinë e Durrësit në datën 05.11.2021, kurse vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë në datën 20.11.2021, pra brenda afatit ligjor 15-ditor sipas nenit 291 të KPP-së. Po kështu, vendimi është i drejtë dhe në përputhje me kompetencat e prokurorit, përpara ndryshimeve të bëra KPP-së me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, i cili në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të drejtësisë i nënshtrohet një procesi të pavarur dhe në liri të plotë për të vendosur me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe në interpretim ligjor të fakteve, në zbatim të normave të së drejtës. Nga argumentet e dhëna në ankim dhe aktet e ndodhura në materialin kallëzues nuk rezultojnë elemente të veprës penale të shpërdorimit të detyrës. Për më tepër, pika 3 e vendimit të prokurorit, për të cilin është paraqitur kallëzimi penal, parashikon të drejtën e ankimit, ndaj kjo vendimmarrje duhej të ishte kontrolluar në rrugë gjyqësore. Po sipas gjykatës, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuar, prokurori N.T. e ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar (me vendim të formës së prerë të KPA-së), sikundër e ka kaluar atë edhe prokurori D.P., vendimi i të cilit kundërshtohet gjyqësisht.

5. Kërkuar ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-800 (158), datë 28.04.2022, ka vendosur lënien e tij në fuqi, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj. Sipas gjykatës së apelit, edhe pse sipas nenit 148 të Kushtetutës prokuroria ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të ushtrojë ndjekjen penale, ky detyrim nuk nënkupton fillimin në çdo rast të procedimit penal. Në

ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore, organi i prokurorisë mbështetet në parimin e ligjshmërisë dhe, në këtë kuadër, vlerëson rast pas rasti nëse ka ose jo elemente të veprës penale. Në rastin konkret, vendimmarrja e prokurorit është bazuar në shkronjën “ç” të nenit 291 të KPP-së, sipas së cilës kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë se fakti nuk ekziston, procedimi penal nuk mund të fillojë. Qëndrimi i mbajtur në shkresën e Prokurorisë së Posaçme, se pretendimet e kallëzuesit duhet të analizohen në kuadër të parashikimeve të nenit 248 të KP-së, nuk krijon detyrim ligjor për prokuroritë dhe gjykatat e tjera lidhur me ekzistencën e faktit penal, pasi një qëndrim i tillë ka karakter orientues të përgjithshëm për të mbështetur konkluzionin e saj për mungesën e kompetencës lëndore dhe jo rrethanë që justifikon ushtrimin e ndjekjes penale për faktin e kallëzuar. Në këtë situatë, vendimmarrja e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është e bazuar në ligj. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuesi ka ushtruar rekurs.

6. Me vendimin nr. 00-2025-520, datë 01.04.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, si dhe se vendimi i gjykatës së apelit ishte në përputhje me vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 2/2013*), për aq sa ky vendim ishte në përputhje me dispozitat procedurale të zbatueshme pas ndryshimit të KPP-së me ligjet nr. 35/2017 dhe nr. 41/2021.

7. Në datën 03.07.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e:

8.1. *Parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve*, pasi hetimi i kallëzimit penal të kërkuesit kundër mjekut, për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i KP-së, për shkak të shumës së dyshuar si përfitim i parregullt, ka qenë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

8.2. *Së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.2.1. *Së drejtës për t’u hetuar dhe për t’u gjykuar nga një prokurori e gjykatë e paanshme*, pasi mjeku i kallëzuar penalisht është me origjinë nga Dibra, ashtu si dhe prokurori dhe gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, dhe ata kanë lidhje

miqësore mes tyre, çka përbënte shkak për ekzistencën e konfliktit të interesit në hetimin dhe gjykimin prej tyre të çështjes.

8.2.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë ka analizuar elementet e veprës penale vetëm për të zgjatur përmbajtjen e vendimit të saj, ndërsa gjykata e apelit ka analizuar shkresën përcjellëse të Prokurorisë së Posaçme pa arsyetuar për thelbin e çështjes.

8.2.3. *Së drejtës për gjykim të drejtë*, pasi vendimi i prokurorit, i mbështetur nga gjykatat, është në kundërshtim me nenet 290 e 291 të KPP-së dhe është marrë tej afatit ligjor 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i këtij kodi. Ndonëse Prokuroria e Posaçme për faktet e kallëzuara ka sugjeruar kryerjen e veprime hetimore në drejtim të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, prokurori nuk ka kryer asnjë verifikim dhe hetim. Ai nuk e ka pyetur kërkuesin si kallëzues dhe as personat që mund të kishin dijeni për veprën dhe subjektet e kallëzuara penalisht, përveçse nuk ka administruar as praktikën e KPK-së, as opinionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për prokurorin e kallëzuar. Për kallëzimin e kërkuesit prokurori duhej të kishte regjistruar procedimin penal dhe pas kryerjes së hetimeve të nevojshme, nëse nuk konstatonte elemente të veprës penale, mund të kishte kërkuar pushimin e çështjes.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor që ka vendosur për rrëzimin e ankimit të tij ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga ai (kërkuuesi). Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

11. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur për mosfillimin e procedimit penal, duke kundërshtuar në thelb mosndjekjen penale të personave të kallëzuar prej tij, për vepra penale që ndiqen kryesisht, ndonëse ai nuk është i dëmtuar ose viktimë e drejtpërdrejtë e atyre veprave penale. Në lidhje me këtë, gjykatat e zakonshme kanë arritur në përfundimin se fakti i kallëzuar për pushimin e procedimit penal nga prokurori i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se nuk ka ndonjë të dhënë të re për rifillimin e ndjekjes penale ndaj mjekut të kallëzuar.

13. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimet në themel të kërkuarit nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndonjë të drejtë të tij kushtetuese substanciale. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih çështjen Renata McKay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006*).

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vetëm fakti i paraqitjes së kallëzimit penal nga kërkuuesi nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e tij në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të

drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.